

L I G J
Nr.7960, datë 11.7.1995

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE FONDIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E
BUJQËSISË (IFAD) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PËR RIAFTËSIMIN E VEPRAVE
TË VOGLA UJITËSE””**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 7491 datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore Kushtetuese”,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huas ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (IFAD)” për financimin e projektit “Për riaftësimin e veprave të vogla ujitëse” për shumën 6.100.000 SDR (9.03 milionë USD).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1153, datë 13.7.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha